



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prilobato Received/Deliverty	21. 04 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	2313/2022		1/3



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.226/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.226/2022 të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokate me adresë kundër organit të punësimit- Sekretariati i Këshillit Gjyqësor, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ lidhur me ankesën A.nr.266/2022 të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpërmjet përfaqësueses së tij me autorizim me datë 11.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin që ti njihet e drejta e kompensimit të shtesave të TI-së në mënyrë retroaktive nga data 04.05.2020 deri me datën 04.05.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor, ndërsa më datë 19.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1298/2022 të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 01-360 të

datës 15.02.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Autorizimin e datës 18.01.2022; Akt emërimit me numër të protokollit 03-368 të datës 29.04.2020; Vendimin me numër KGJK.nr.152/2021 të datës 28.05.2021 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin me Nr.02/37 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 144/2022 të datës 21.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2198/2022 të datës 19.04.2022; Listën e pagave për periudhën 01.08.2021-31.08.2021; Listën e pagave për periudhën kohore 01.02.2021-30.09.2021; Emalin e datës 19.08.2021; Kërkesën e datës 24.01.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi së janë përmbushur kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativ të iniciuar me ankesën A.nr.266/2022 të datës 11.03.2022, **SEPSE:**

Bazuar në provat e lëndës përkatësisht Akt Emërimit të datës 29.04.2020, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është emëruar në pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informativë për Përkrahje*, në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan. I njëjti me datë 17.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin që t'i njihet e drejta për kompensim shtesë në pagë prej 200 Euro për fushën e Teknologjisë Informativë, për të ardhmen si dhe kompensimin retroaktiv nga data 04.05.2020, duke ju referuar vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.07/29 të datës 31.07.2008 dhe Nr.02/39 të datës 08.10.2008. Ndërsa Këshilli përmes Vendimit 361/2021 të datës 14.01.2021 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës 17.11.2020.

Me tej, nga vlerësimi i shkresave të lëndës rezulton se Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes Vendimit KGJK.nr.152/2021 të datës 28.05.2021 ka aprovuar njohjen e shtesave në pagë për stafin e TI-së të punësuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe gjykata, duke filluar nga data e pranimit të tyre në punë. Ankuesi me datë 24.01.2022 ka parashtruar kërkesë të organi i punësimet për kompensimin e shtesave në pagë në mënyrë retroaktiv nga data 04.05.2020 deri 04.05.2020, me arsyetimin se Këshilli Gjyqësor i Kosovës sipas Vendimit KGJ K.nr.152/2021 të datës 28.05.2021 i ka njohur të drejtën e kompensimit të shtesave të IT-së në shumë prej 200 euro vetëm nga muaji qershor 2021. Lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 24.01.2022, Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Vendimin KA.nr.05/2022 ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e ankuesit.

Andaj, Kolegji duke u bazuar në rrethanat si me lartë, vlerëson se objekti i ankesës A.nr.266/2022 i datës 11.03.2022 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankuesit të datës 17.11.2020, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me datë 14.01.2021 përmes Vendimit A.nr.361/2020, rrjedhimisht objekti i të dy ankesave bazohet në të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, e që në rastin konkret është njohja e së drejtës së kompensimit të shtesave të IT-së, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data e themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht nga data 04.05.2020. Kështu që, nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktikë.*, Kolegji konstatoi

se janë përmbushur kushtet ligjore që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.266/2022 të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

Ashtu siç u tha me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.226/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

